



Instituti i Kosovës për Drejtësi

**Analizë e shkurtë:
Nr. 01/2017 - IKD**

**VENDIMET E KUNDËRLIGJSHME TË KRYEPROKURORIT
TË SHTETIT DHE KËSHILLIT PROKURORIAL PËR
TRANSFERIMIN E PROKURORËVE NË PROKURORINË
SPECIALE TË REPUBLIKËS TË KOSOVËS**

Prishtinë, shkurt 2017

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD)

Asnjë pjesë e këtij materiali nuk mund të printohet, kopjohet, shumëfishohet në çdo formë elektronike ose të shtypur, ose në çdo formë të shumëfishimit tjetër pa pajtimin e Institutit të Kosovës për Drejtësi.

RRETH IKD

IKD, Instituti i Kosovës për Drejtësi, është organizatë jo-qeveritare dhe jo-fitimprurëse e politikave publike, fabrikë e mendimeve e specializuar në sektorin e drejtësisë.

IKD

Hyrja 1, Kati 1, Nr. 1
Rr. Rustem Statovci
Prishtinë
E: info@kli-ks.org
www.kli-ks.org

përkrahur nga:



British Embassy
Pristina

Shkurt 2017

Prishtinë, Republika e Kosovës

PËRMBAJTJA:

I. VENDIMET E KUNDËRLIGJSHME TË KRYEPROKURORIT TË SHTETIT DHE KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS.....	4
Rekomandim.....	6

I. VENDIMET E KUNDËRLIGJSHME TË KRYEPROKURORIT TË SHTETIT DHE KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

Instituti i Kosovës për Drejtësi (IKD) reagon kundër vendimeve të kundërligjshme të Kryeprokurorit të Shtetit, z. Aleksandër Lumezi dhe Këshillit Prokurorial i Kosovës (KPK), rreth praktikës së “transferimit” të prokurorëve të shtetit në kundërshtim me ligjin dhe rregulloret e miratuara nga vet KPK.

Më 6 janar 2017, Kryeprokurori i Shtetit me Vendim, sipas kërkesës së paraqitur nga Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK) ka “transferuar përkohësisht” prokurorin e Departamentit për Krime të Rënda të Prokurorisë Themelore në Prizren, z. Sylë Hoxha në PSRK.

Vendimi i Kryeprokurorit Lumezi përcakton se prokurori Hoxha ka të drejtë në beneficionet që dalin nga ushtrimi i funksionit të prokurorit në PSRK.

Gjithashtu, KPK në takimin e mbajtur më datë 1 shkurt 2017, ka marr Vendim për “transferimin” e prokurorit Sylë Hoxha në PSRK.

Në takimin e KPK-së, në pikën lidhur me transferimin e Prokurorit Hoxha, anëtarë të KPK-së kanë shprehur dyshimet e tyre lidhur me ligjshmërinë e transferimit të prokurorëve përfshirë “transferimin e prokurorit Hoxha” pa kaluar përmes institutit të konkursit.

Vendimet e Kryeprokurorit të Shtetit dhe KPK bien në kundërshtim me Ligjin për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe Rregulloren për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit.

KPK rregulloren e lartë përmendur e kishte miratuar më 31 mars 2016. Rregullorja për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve të Shtetit ka përcaktuar procedurat dhe kriteret e transferimit dhe avancimit të prokurorëve të shtetit. Zbatimi i kësaj rregullore do të ndalonte praktikën e keqe të instaluar nga KPK që nga viti 2011, duke transferuar dhe avancuar prokurorë pa proces të drejtë, paanshëm dhe të bazuar në meritë dhe duke anashkaluar institutin e konkursit.

Praktika e shkeljes së ligjit nga Kryeprokurori i Shtetit dhe KPK është kthyer në standard të qeverisjes së sistemit prokurorial. Bazuar në këtë standard, ligji interpretohet dhe zbatohet për interesa të ngushta të personave të caktuar brenda sistemit prokurorial.

Vendimet e Kryeprokurorit të Shtetit dhe KPK-së për “transferimin” e prokurorit Hoxha në PSRK bien në kundërshtim me vet politikën e miratuara nga Këshilli. Sipas përcaktimit të definicionit lidhur me transferimin e prokurorëve të shtetit, është përcaktuar qartë se transferimi duhet të jetë i nivelit të njëjtë dhe sipas kërkesës së vet prokurorit edhe në nivel më të ultë.

Neni 2 i rregullores përkufizon dhe bën dallimin në mes të transferimit dhe avancimit të prokurorëve. Kjo rregullore ka përcaktuar se transferimi mund të jetë i përkohshëm dhe i përhershëm, si më poshtë:

Transferimi i përkohshëm nënkupton transferimin e një prokurori me afat të caktuar. Transferimi i përhershëm nënkupton transferimin e një prokurori nga një Prokurori Themelore në një tjetër Prokurori Themelore ose nga një Departament në Departament tjetër të nivelit të njëjtë dhe me kushte të njëjta. Transferimi nënkupton edhe transferimin në Departament të nivelit më të ulët me kërkesë të vet prokurorit.

Kalimi i prokurorit nga një prokurori e nivelit më të ultë (Prokuroria Themelore) në nivel me të lartë (PSRK) sipas rregullores së lartpërmendur nënkupton avancim apo ngritje në detyrë.

Avancimi i prokurorit Hoxha nga Prokuroria Themelore në Prizren në PSRK, bie në kundërshtim edhe me nenin 3 të Rregullores, e cila përcakton parimet themelore mbi të cilat duhet të udhëhiqet KPK gjatë procesit të transferimit dhe avancimit të prokurorëve. Ky nen përcakton se zhvillimi në karrierë i prokurorëve, avancimi dhe transferimi i tyre duhet të bazohet në kritere objektive siç janë: aftësitë profesionale, merita dhe përvoja profesionale, si dhe zhvillimi në karrierë, avancimi dhe transferimi duhet të bazohen vetëm sipas ligjit dhe kësaj rregullore dhe me pëlqimin e prokurorëve.

Kriteret që përcaktojnë se Prokuroria Themelore është nivel më i ultë se PSRK:

Paga e prokurorëve:

Neni 21 i Ligjit për Prokurorin e Shtetit përcakton kompensimin e prokurorëve, si më poshtë:

Gjatë periudhës së shërbimit, prokurorët e shtetit gëzojnë pagat bazë si në vijim:

1.1. Kryeprokurori i Shtetit pranon pagë ekuivalente me atë të Kryetarit të Gjykatës Supreme.

1.2. Prokurorët me mandat të përhershëm në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit pranojnë pagë ekuivalente në shkallë nëntëdhjetë për qind (90%) me pagën e Kryeprokurorit të Shtetit.

1.3. Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale pranon pagë ekuivalente në shkallë nëntëdhjetë e pesë (95) % me pagën e Kryeprokurorit të Shtetit.

1.4. prokurorët me mandat të përhershëm në Prokurorinë Speciale marrin pagë ekuivalente me pagën e prokurorëve në Zyrën e Kryeprokurorit të Shtetit;

1.5. Kryeprokurori i Prokurorisë së Apelit merr pagë ekuivalente me pagën e kryetarit të Gjykatës së Apelit;

1.6. Prokurorët me mandat të përhershëm në Prokurorinë e Apelit pranojnë pagë ekuivalente në shkallë nëntëdhjetë për qind (90%) me pagën e Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit.

1.7. Kryeprokurorët e prokurorive themelore marrin pagë ekuivalente me kryetarët e gjykatave themelore.

1.8. Secili prokuror me mandat të përhershëm në Prokurorinë Themelore pranon pagë jo më pak se shtatëdhjetë për qind (70%) e pagës së Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore.

Këshilli do të nxjerr skemën për kompensime shtesë që pasqyron përgjegjësitë e veçanta të prokurorit që paraqitet para Departamentit të Krimeve të rënda pranë Gjykatës Themelore, por në asnjë rast shuma e pagës bazë dhe pagesës shtesë nuk do të kalojë nëntëdhjetë për qind (90%) të pagës së Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore.

Kriteret për prokurorë në Prokurorinë Themelore dhe PSRK

Për të ushtruar funksionin e prokurorit në Departamentin për Krime të Rënda apo për të Mitur në Prokurorinë Themelore, prokurori duhet të ketë së paku tri **(3) vite përvojë si prokuror apo gjyqtar në lëmin penal si dhe bazuar në vlerësimin e performancës.**

Për të ushtruar funksionin e prokurorit në Prokurorinë Speciale, prokurori duhet të ketë së paku gjashtë **(6) vite përvojë si prokuror, nga të cilat katër (4) vite përvojë si prokuror në Departamentin e Krimeve të Rënda të Prokurorisë Themelore.**

IKD vlerëson nevojën e KPK-së për plotësimin e pozitave të lejuara për prokurorë në PSRK, për të cilën ka avokuar dhe avokon në baza ditore në të gjitha aktivitetet e saj publike. IKD vazhdimisht ka kërkuar nga KPK që të plotësoj pozitave të lira për prokurorë në PSRK, ku nga 18 pozita të lejuara për prokurorë në këtë prokurori, janë të plotësuara vetëm 9. Megjithatë, IKD pret nga KPK që gjatë procesit të plotësimit të këtyre pozitave, të zbaton strikt Ligjin për KPK-në, Ligjin për Prokurorin e Shtetit, rregulloret dhe aktet e brendshme të miratuara nga vet Këshilli.

Para z. Sylë Hoxha në mënyrë të njëjtë ishte vepruar me prokurorin z. Abdurrahim Islami, i cili në kundërshtim me ligjin dhe Rregulloren për Transferimin dhe Avancimin e Prokurorëve ishte transferuar nga Prokuroria Themelore në Prishtinë në PSRK, për të cilën shkelje IKD ka reaguar publikisht më 12 dhjetor 2016.

Praktika e instaluar nga Kryeprokurori i Shtetit dhe KPK, lidhur me shkeljen e ligjit dhe akteve të brendshme gjatë ushtrimit të funksioneve dhe përgjegjësive të tij, përmes miratimit të Vendimeve të kundërligjshme zbehë edhe më tej besimin e publikut, qytetarëve dhe sistemit prokurorial për të ndërtuar një sistem të paanshëm, të drejtë, të pavarur dhe profesional.

Rekomandim

IKD i rekomandon KPK-së, që të ri vlerësoj vendime, dhe të marr vendime të bazuara në ligj dhe aktet e brendshme të Këshillit Prokurorial të Kosovës.